

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË
P. nr. 134/08
19 Nëntor 2009

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, me Trupin gjykues të përbërë nga gjykatësja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e Trupit gjykues, dhe gjykatëset e EULEX-it Angela Kaptein dhe Christine Lindemann-Proetel si anëtare të Trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Tara Khan si zyrtare për procesverbal, në çështjen penale kundër;

DJORDJEVIC Predrag, i akuzuar, sipas Aktakuzës së Ndryshuar të Zyres së Prokurorisë Speciale PP. nr. 71/08 e cila është datuar dhe paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 02 korrik 2009, për veprat penale si në vijim;

- **Nxitje të Urrejtjes, Përçarjes ose Mosdurimit Kombëtar, Racor, Fetar a Etnik**, në kundërshtim me nenin 115 paragrafi (3) lexuar me paragrafin (1) të Kodit Penal të Kosovës (KPK)
- **Kryerje të Veprave Terroriste**, në kundërshtim me nenin 110 paragrafi (2) dhe (1) lexuar me nenin 109 paragrafin (1), nën-paragrafin 2, 7 dhe 10 të KPK
- **Vrasje të Rëndë në Tentativë**, në kundërshtim me nenin 146 dhe 147 lexuar me nenin 20 të KPK

Pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit kryesor më 27, 29, 30 korrik, 03 gusht, 01, 03, 24, 30 shtator, 13, 15, 21 tetor, 05, 11, 17 dhe 19 nëntor, të gjitha në prani të të akuzuarit Djordjevic Predrag, avokatit të tij mbrojtës Miodrag Brkljac dhe/apo Ljubomir Pantovic, dhe prokurores Publike të EULEX-it Isabelle Arnal, pas pleqërimit dhe votimit të Trupit gjykues të mbajtur më 19 nëntor 2009, sipas nenit 392 paragrafi (1) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), shpalli – të njëjtën ditë – në seancë publike dhe në prani të të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës dhe Prokurorit Publik të EULEX-it këtë

AKTGJYKIM

I akuzuari **DJORDJEVIC Predrag**, pseudonimi Djordje, i biri i Djordjevic Ljubodrag dhe Vukovic Slavica, i lindur më 10 prill 1980 në Zemun, Republikë e Serbisë, i kombësisë serbe dhe shtetas i Serbisë, vendqëndrimi i fundit i njohur në fshatin Skrzuti, Komuna e Uzhicës, Republikë e Serbisë, i pamartuar, jeton me prindër, shkollim i lartë

tre vjet të shkollimit profesional, i papunë, të ardhurat familjare 200-300 euro në muaj, i padënuar më parë, në paraburgim prej 14 qershorit 2008

SHPALLET FAJTOR

- **sepse** më 14 qershor 2008 rreth orës 01:00 i akuzuari ka hipur në kupolat e Xhamisë Isa Beu në Mitrovocën e Jugut dhe ka vendosur nje flamur që simbolizon fenë e Krishterë ortodokse në majë të njerës nga kupolat. Në këtë mënyrë Djordjevic Predrag publikisht ka nxitur dhe përhapë mosdurim fetar dhe etnik në mes të shumicës së shqiptarëve mysliman dhe shumicës serbe të krishterë ortodoks që jetojnë në Kosovë. Veprimi i tij ka pasur mundësi të prishë rendin publik.

Duke vepruar në këtë mënyrë, i akuzuari Djordjevic Predrag ka kryer dhe mban përgjegjësi penale për veprën penale të

A, Nxitjes së Urrejtjes, Përçarjes ose Mosdurimit Kombëtar, Racor, Fetar a Etnik, në kundërshtim me nenin 115 paragrafi (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

- **sepse** më 14 qershor 2008 rreth orës 01:40 Djordjevic Predrag, i armatosur me thikë dhe pistoletë ka hyrë në oborrin e rrethuar të Stacionit të Policisë së Kosovës në Mitrovicën e Jugut dhe me qëllim që të privojë viktimën e tij nga jeta, nga afër, ka shtënë në policin Enver Pllana – i cili ishte duke kryer detyrën e tij në mbrojtjen e rendit ligjor - me pistoletë “Jieffeco” lloji i modelit 19078, kalibri 7,65x17 mm, numri serik 20643, duke shkaktuar lëndim të rëndë trupor. Pastaj Djordjevic Predrag ka ecur prapa me fytyrë kah Enver Pllana i cili ka shtënë disa herë në të. I akuzuari, tashmë i plagosur dhe kur ka dalur jashtë rrethojës, ka lëshuar pistoletën e tij dhe ka shkuar te hyrja e stacionit policor, ka hyrë në ndërtesë me thikë në dorë e cila i ka rënë përpara se të hyjë në stacion. Ai ka shkuar në drejtim të polices Arjeta Xhosha – e cila pasi kishte parë se Enver Pllana ishte qëlluar, kishte ikur brenda ndërtesës të stacionit policor – duke mospërfillur urdhrin e saj për tu ndalur. Rreshterja Xhosha ka shtënë disa herë në drejtim të Djordjevic Predrag, deri sa ai u rrëzua për shkak të lëndimeve.

Duke vepruar kështu, i akuzuari Djordjevic Predrag ka kryer dhe mban përgjegjësi penale për shkak të veprës penale të

B, Vrasje e Rëndë në Tentativë, në kundërshtim me nenin 147 pika 10 e KPPK lidhur me nenin 20 paragrafi (1) i KPPK përkitazi me veprimet e tij kundër Enver Pllanës.

C, Akuza e Kryerjes së Veprave Terroriste, në kundërshtim me nenin 110 paragrafi (1) dhe (2) lexuar me nenin 109 paragrafi (1) pikat 2, 7, dhe 10 të KPPK refuzohet sipas nenit 389 pika 1) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

PRANDAJ, i akuzuari DJORDJEVIC PREDRAG

DËNOHET

- me 6 /gjashtë/ muaj burgim për veprën penale të Nxitjes së Urrejtjes, Përçarjes ose Mosdurimit Kombëtar, Racor, Fetar a Etnik /Pika A/
- me 6 /gjashtë/ vjet burgim për veprën penale të Vrasjes së Rëndë në Tentativë /Pika B/

Dënimi unik është përcaktuar në 6 /gjashtë/ vjet e 3 /tre/ muaj burgim, sipas nenit 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) pika 2 e KPPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 14 qershor 2008 do të llogaritet në dënimin e shqiptuar sipas nenit 73 paragrafi (1) i KPPK.

I akuzuari do t'í kompenzojë shpenzimet e procedurës penale siaps nenit 102 paragrafi (1) i KPPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të lëshohet nga gjykata në momentin kur të sigurohen informacionet përkatëse sipas nenit 100 paragrafi (2) i KPPPK.

Kërkesat pronësore të palëve të dëmtuara Enver Pllana dhe Arieta Xhoshja referohen në procedurë civile sipas nenit 112 paragrafi (2) i KPPPK.

ARSYETIMI

A. HISTORIKU PROCEDURAL – AKTAKUZA

Më 12 dhjetor 2008, Prokurori Publik i Qarkut për Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP. no. 71/08 të datës 12.12.2008 të cilën e ka paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Aktakuza ka pretenduar se i pandehuri ka kryer veprat penale në vijim

- Nxitje të Urrejtjes, Përçarjes ose Mosdurimit Kombëtar, Racor, Fetar a Etnik, në kundërshtim me nenin 115 paragrafi (3) lexuar me paragrafin (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK)
- Kryerje të Veprave Terroriste, në kundërshtim me nenin 110 paragrafi (2) dhe (1) lexuar me nenin 109 paragrafi (1), nën-paragrafët 2, 7, dhe 10 të KPPK.

Më 16 prill 2009 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) mori përsipër këtë çështje nga Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë dhe më 02 korrik 2009 ka ngritur Aktakuzë të Ndryshuar me datë 30 qershor 2009 duke zgjëruar akuzat në veprat penale të Vrasje e Rëndë në Tentativë, në kundërshtim me nenin 147 pika 10 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 20 paragrafi (1) i KPK dhe referuar dispozitave përkatëse të Kodit Penal të Kosovës lidhur me dy akuzat fillestare.

Aktakuza e Ndryshuar e PSRK është konfirmuar përmes Aktvendimit të Gjykatësit për konfirmim të aktakuzës më 06 korrik 2009.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 17 nëntor 2009, Prokurori Publik i PSRK tërheqi akuzën e Kryerjes së Veprave Terroriste sipas nenit 52 të KPPK dhe në përputhje me këtë gojarisht e ka ndryshuar Aktakuzën e Ndryshuar.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

Sipas nenit 23 pika 1) i) e KPPPK, gjykatat e qarkut kanë kompetencën të dëgjojnë çështjet penale që përfshijnë akuzat për të cilat ligji lejon caktimin e dënimit me më së paku 5 vjet. Sipas nenit 27 paragrafi (1) i KPPPK, juridiksioni territorial i jepet gjykatës brenda territorit të së cilës pretendohet se është kryer krimi.

Siç është paraqitur më lart, akuza e Kryerjes së Veprave Terroriste sipas nenit 110 paragrafi (2) lejon caktimin e dënimit minimal prej 15 vjet burgim. Për më shumë, aktakuza në këtë çështje pretendon se i akuzuari ka kryer veprat në Mitrovicë.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është organi ligjor kompetent të dëgjojë këtë çështje penale.

Sipas nenit 3.1 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, gjykatësit e EULEX-it të caktuar në procedura penale do të kenë juridiksionin dhe kompetencat mbi çdo lëndë që hetohet apo ndiqet nga PSRK. Siç është thënë më lart, PSRK ka marrë përsipër lëndën nga Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë më 16 prill 2009. Prandaj, Gjykatësit e EULEX-it e caktuar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kanë kompetencat të gjykojnë këtë çështje penale. Trupi gjykues ka qenë i përbërë nga Gjykatësja penale e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e trupit gjykues dhe gjykatëset penale të EULEX-it Angela Kaptein dhe Christine Lindemann-Proetel si anëtare të Trupit gjykues. Të tri gjykatëset janë të caktuara të punojnë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

Asnjëra nga palët nuk ka pasur kundërshtime lidhur me përbërjen e Trupit gjykues.

C. PËRMBLEDHJE E PROVAVE TË PARAQITURA

Gjatë rrjedhës së procedurës në shqyrtimin kryesor, janë dëgjuar dëshmitarët në vijim:

- (1) Arjeta Xhoshja – Palë e dëmtuar, 27 korrik 2009
- (2) Enver Pllana – Palë e dëmtuar, 29 korrik 2009
- (3) CC – Rojë sigurimi, 30 korrik 2009
- (4) DD – Rojë sigurimi, 30 korrik 2009
- (5) EE – Polic, 30 korrik 2009
- (6) FF – Polic, 30 korrik 2009
- (7) GG – Police, 03 gusht 2009
- (8) HH – Polic, 03 gusht 2009
- (9) II – Fqinj, 03 gusht 2009
- (10) JJ – Polic, 01 shtator 2009
- (11) KK – , 01 shtator 2009
- (12) LL – , 03 shtator 2009
- (13) MM – , 03 shtator 2009
- (14) NN – Polic, hetues, 24 shtator 2009
- (15) OO – Polic, 24 shtator 2009
- (16) PP – Polic, 24 shtator 2009
- (17) QQ – Police, 24 shtator 2009
- (18) RR – Mjek, 30 shtator 2009
- (19) SS – asistent anesteziolog, 30 shtator 2009
- (20) TT – Polic, 13 tetor 2009
- (21) UU – , 15 tetor 2009
- (22) VV – Infermiere, 21 tetor 2009
- (23) ZZ – Police, 21 tetor 2009
- (24) XX – Polic, 21 tetor 2009
- (25) WW – Ekspert i ballistikës, 05 nëntor 2009
- (26) AA – , 03 shtator 2009
- (27) BB – , 15 tetor 2009

Gjatë shqyrtimit kryesor janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve në vijim:

- (28) TU – Police, deklarata e 19.06.2008, lexuar më 01 shtator 2009
- (29) XV – civil në Stacionin e Policisë, deklarata e 15.06.2008, lexuar më 01 shtator 2009
- (30) ZO – , deklarata e 14.06.2008, lexuar më 21 tetor 2009

Gjatë shqyrtimit kryesor provat në vijim janë paraqitur nga Prokurori Publik i EULEX-it dhe janë futur në evidencë:

- (1) Fotot origjinale 1, 2, 5, 6, dhe 27 korrik 2009 (Ekzemplarët 1 dhe 2)
- (2) Foto e të dyshuarit i shtrirë në tokë, më 30 korrik 2009, (Ekzemplari 8)
- (3) Raporti Informativ i SHPK i datës 16/06/08, më 24 shtator 2009, (Ekzemplari 9)
- (4) Raporti Informativ i SHPK i datës 17/06/08, më 24 shtator 2009 (Ekzemplari 10)
- (5) Skicat origjinale të vizatuara nga TT, më 13 tetor 2009 (Ekzemplari 11)
- (6) "Video Camera Pictures (Fotot e Video Kamerës)", foto me ngjyra, më 13 tetor 2009 (Ekzemplari 12)
- (7) Raporti i Policisë me shënime i datës 07/10/09, më 21 tetor 2009 (Ekzemplari 13)
- (8) Raportet mjekësore të datës 14/06/09, më 21 tetor 2009 (Ekzemplari 14 A,B)

Gjatë procedurës së shqyrtimit kryesor provat në vijim janë paraqitur nga Avokati mbrojtës dhe janë futur në evidencë:

- (1) Një vizatim i dy armëve, nga RH më 05 nëntor 2009 (Ekzemplari 15)
- (2) Emblema e Beretës së Kuqe e paraqitur më 17 nëntor 2009 (Ekzemplari 16)

Kur është ngritur aktakuza provat në vijim janë paraqitur nga prokurori Publik i EULEX-it dhe janë futur në evidencë gjatë procedurës së shqyrtimit kryesor:

- (1) Mendimi i ekspertit mbi analizën e ADN-së i datës Zagreb, 25/08/2008 përpiluar nga PQ
- (2) Ekspertiza balistike e datës 10/07/2008 e përgatitur nga WW
- (3) Raportet nga vendi i ngjarjes, të dhënat nga spitali, raportet forenzike dhe dokumente të tjera

Gjatë procedurës së shqyrtimit kryesor janë pranuar provat si në vijim:

- (1) Ekspertiza e dytë mbi analizën e ADN-së e datës 04/11/2009 përpiluar nga Laboratori Qendror i PK, ES (sipas propozimit të Prokurorit Publik)
- (2) Vlerësimi psikiatrik i të akuzuarit i datës 09 tetor 2009, përpiluar nga MZ, neuro-psikiatër (sipas propozimit të të dy palëve)
- (3) Inspektimi i vendit të ngjarjes – xhamisë është bërë më 15 shtator 2009 sipas propozimit të Prokurorit Publik dhe procesverbali nga ky inspektim është lexuar në seancën e 24 shtatorit 2009 sipas nenit 367 të KPPPK.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 17 nëntor 2009 i akuzuari, Djordjevic Predrag, ka dhënë deklaratë dhe është përgjigjur në pyetje.

D. VLERËSIMI I PROVAVE TË PARAQITURA

1. Gjetjet faktike

Pas paraqitjes së provave gjatë procedurës së shqyrtimit kryesor, Gjykata i konsideron si të vërtetuara faktet në vijim:

Më 13 qershor 2008, në orët e vona të natës, i akuzuari Djordjevic Predrag ka arritur në Mitrovicën e Veriut dhe pasi ka kaluar rreth një orë e gjysmë në kafenenë Bip-Bap duke pirë venë, ka kaluar në këmbë urën kryesore për në Mitrovicën e Jugut rreth orës 00:23 më 14 qershor 2009. Ai ka vazhduar të ecë në drejtim të jugut derisa ka parë xhaminë e Isa Beut. Ai ka hipur lart deri te kupolat në një shufër metalike dhe në majë të njëres nga kupolat ka vendosur një flamur me kryq në të që simbolizon fenë e tij Krishtere ortodokse.

Pastaj është nisur prapa kah veriu dhe rreth orës 01:16 ka kaluar kah ndërtesa e Jugobankës, ka ecur drejt urës por është kthyer djathtas, ka bërë një rreth dhe është nisur prapa kah Stacioni Policor i Mitrovicës së Jugut. Ka kaluar dy herë kah Postblloku i UNMIK-ut në ndërtesën e Jugobankës dhe postbllokun e vogël, të jashtëm, pika Statike Një e Stacionit Policor. Rreth orës 1:22 kur është paraqitur për të tretën herë, polici në detyrë në Pikën Statike Një, FF, doli nga postblloku dhe i akuzuari shkoi në drejtim të tij. Polici i ka kërkuar atij dokumentet e identifikimit por i akuzuari është shtirë se gjoja është shurdh-memec. Polici FF i bëri shenjë atij me dorë që ta përcjellë, gjë që i akuzuari edhe bëri, dhe ata dolën jashtë rrethojës së stacionit policor. Polici FF i bëri me shenjë kolegut të tij, EE i cili ishte në detyrë në Pikën Statike 2, pika e informacionit në stacionit, të afrohet te ata. Polici EE poashtu u mundua të komunikojë me të akuzuarin por pa sukses. Ata thirrën Rreshteren Arjeta Xhosha e cila ishte personi përgjegjëse e ndërrimit të mëngjesit. Ajo poashtu u mundua të komunikojë me të akuzuarin me gjeste, mirepo pa ndonjë rezultat meqë i akuzuari vazhdoi të shtihej se nuk kupton asgjë. Policët FF dhe EE kontrolluan çantën e të akuzuarit duke e urdhëruar ta hiqte nga shpina dhe ta hapte. I akuzuari bëri këtë, e hapi çantën dhe e shkundi, duke treguar se nuk ka asgjë brenda. Policët ishin të kënaqur me këtë, nuk e kontrolluan çantën terësisht dhe nuk e bënë bastisjen e trupit. Rreshterja Xhoshka ka shkuar brenda për të thirrur përkthyesin për shurdh-memec, por, nuk ka mund të vëjë kontakt me të. Polici EE u kthye te vendi i tij i punës brenda stacionit. Arjeta Xhoshka prapë doli jashtë, e përcjellur nga polici Enver Pllana. Në këtë moment, jashtë rrethojës ishin i akuzuari dhe roja e sigurimit e Ballkan-it, CC, i cili erdhi të paralajmërojë policët se i akuzuari i dukej i dyshimtë dhe agresiv, gjykuar nga reagimet e tij kur kishte vizatuar një shtëpi dhe kishte shkruar Skenderaj në të me qëllim që të kuptonte se ku jetonte. (I akuzuari i kishte kapur dorën CC kur ai kishte dashur të prejë një insekt të vogël në kabinën e tij të recepcionit.) Brenda rrethojës ishin Arjeta Xhoshka, e cila pas informacionit të rojës së sigurimit kontaktoi njësitin në Skenderaj, dhe Enver Pllana. Kur Rreshterja Xhoshka dhe polici Pllana dolën nga ndërtesa e stacionit, rreth orës 01:34, polici FF u kthye te pika e tij Statike Një.

Arjeta Xhoshja udhëzoi Enver Pllanën të sjellë të akuzuarin brenda stacionit të policisë derisa të vijë ndihma nga Skenderaj. Enver Pllana doli jashtë portës, iu afrua të akuzuarit, e kapi për krahu dhe e udhëzoi të vijë me të. Ata ecën krahpërkrah, duke qenë i akuzuari në anën e djathtë të policit Pllana. Kur ata hynë brenda portës, brenda oborrit të policisë, i akuzuari futi dorën e djathtë në xhep, nxorri pistoletën e tij dhe menjëherë shtiu nga afër në policin, duke e qëlluar në anën e djathtë në lartësi të belit. Pastaj i akuzuari eci prapa duke u larguar nga Enver Pllana por tërë kohën i kthyer me fytyrë nga ai. Polici i plagosur nxorri armën e tij dhe shtiu 9 herë në sulmuesin e tij. Djordjevic Predrag, tashmë i plagosur dhe jashtë portës afër kioskut të sigurimit të Ballkan-it, lëshoi pistoletën e tij dhe shkoi drejt hyrjes së ndërtesës së stacionit policor. Ai përplasi derën me supin e tij dhe duke bërë këtë, lëshoi thikën që e kishte në dorë përpara se të hynte në stacion. Brenda stacionit, në një distancë prej dy deri dy metra e gjysmë ai hasi në Arjeta Xhoshën e cila kishte ikur brenda ndërtesës sapo ishte qëlluar Enver Pllana. Rreshterja Xhoshja i thirri atij me zë të lartë që të ndalojë por i akuzuari vazhdoi të lëvizë në drejtim të saj. Arjeta Xhoshja ka lëvizur prapa, e kthyer me fytyrë kah i akuzuari, dhe shtiu në të 10 herë derisa Djordjevic Predrag u rrëzua për shkak të lëndimeve të tij.

Të dy, polici Enver Pllana dhe i akuzuari Djordjevic Predrag, janë dërguar në Klinikën Universitare në Prishtinë.

Enver Pllana ka pësuar një plagë të shkaktuar nga armë zjarri në anën e djathtë të belit. Predha ende gjendet brenda trupit të tij për shkak të kontraindikacioneve të ndërhyrjes kirurgjike.

Arjeta Xhoshja ka krahun e lënduar, tendinën në anën e epërme dhe të poshtme të krahut.

Djordjevic Predrag ka pësuar një plagë të shkaktuar nga armë zjarri në zonën e qafës në gluton ('gluton' - *fjalë e pakuptueshme-shënim i përkthyesit*) e djathtë. Ai ka pësuar thyerje të ashtit të pjesës së epërme të krahut të djathtë dhe shqyerje të thella në të dy eshtrat e kofshave. Gishti i katërt i dorës së majtë ka qenë i dërrmuar dhe varej, dhe është dashur të amputohet. Ka pasur një shqyerje në gishtin e tretë të dorës së majtë.

2. Provat lidhur me incidentin me flamur

Nuk ka pasur prova të drejtëpërdrejta që lidhin të akuzuarin me flamurin mbi xhami derisa ai vetë nuk ka dhënë një **deklaratë** dhe është përgjigjur në pyetje në seancën e 17 nëntorit 2009. Ai është paralajmëruar sipas ligjit se ajo çfarë thotë mund të përdoret si provë kundër tij. Ai ka pranuar se ka hipur në autobus në Beograd dhe ka shkuar në Mitrovicën e Veriut ku kaluar ca kohë në një kafiteri. Ai ka shkuar në anën jugore dhe ka gjetur xhaminë. Ai është ngjitur deri te kupolat duke përdorur një shufër metalike dhe ka vendosur flamurin që e ka pasur në çantë në njërin nga kupolat. Duke zbritur përmes shufrës, ka rënë në një lloj kulmi por disi ka arritur të zbresë poshtë. Nuk ka dëmtuar asgjë.

Deklarata e të akuzuarit mbështetet nga prova indirekte. **Video rexhistrimi** tregon atë rreth orës 00:22 (Kamera 08) në pjesën veriore të urës duke iu drejtuar Policit ndërkombëtar dhe pastaj policëve të PK përpara se të kalojë urën në drejtim të jugut dhe duke kaluar përpara njërive të policisë pa u ndaluar në orën 00:23:16 (Kamera 10). Rreth orës 01:10 (Kamera 01) ai kalon pranë Pikës Statike 1 të Stacionit të Policisë të Mitrovicës së Jugut duke u kthyer nga drejtimi i jugut kah veriu.

Duke marrë parasysh deklaratën e të akuzuarit është e logjikshme të përfundohet se në këto 47 minuta ai ka shkuar në këmbë deri te xhamia, është ngjitur deri te kupolat, ka vendosur flamurin, pastaj ka zbritur dhe prapë është nisur për në veri.

As **ekspertiza e parë e ADN-së** e as **e dyta** nuk kanë mundur të identifikojnë gjurmët e gjakut në flamur me mostrën e ADN-së së të akuzuarit. Poashtu, nuk ka qenë e mundur të vërtetohet nëse kontaminuesit e gjetur në flamur kanë qenë të kohëve të fundit (siç është sugjeruar nga prokurori duke iu referuar dritares së thyer të xhamisë) apo të mëhershëm. Megjithatë, duke pasur parasysh deklaratën e të akuzuarit se flamuri ishte i tij dhe se ai e ka pasur në çantën e shpinës me qëllim që ta vendosë në kupolë, gjurmët në flamur e humbin rëndësinë e tyre.

Deklarata e të akuzuarit poashtu mbështetet nga dy deklaratat e dy **dëshmiatrëve** të vetëm të dëgjuar në lidhje me incidentin me flamur: ajo e **AA** i xhamisë dhe ajo e **BB** së xhamisë.

BB ka deklaruar se ai ka qenë përgjegjësi për mbylljen e të gjitha dyerve të xhamisë, gjë që ai e ka bërë në mbrëmjen përpara incidentit rreth orës 23:00-23:10. Ai poashtu ka deklaruar se dritarja e thyer e aneksit ka qenë e thyer përpara se të ndodhte incidenti me flamur. Ai ka vërtetuar dhe ka përsëritur deklaratën e tij poashtu në inspektimin e vendit të ngjarjes gjatë së cilit ai i ka shoqëruar Trupin gjykues dhe palët.

Duke u përgjigjur në një numër pyetjesh **BB** vazhdimisht ka vërtetuar se dritarja ishte thyer një ditë përpara se të vendosej flamuri në kupolë. Muezini e kishte thirrur dhe e kishte informuar lidhur me dritaren e thyer një ditë përpara incidentit me flamur. Sa i përket incidentit me flamur, **BB** kishte thirrur policinë. Ata nuk e kishin konsideruar dritaren e thyer si çështje serioze meqë ata kanë përdorur këtë aneks vetëm të premtëve për t'u falur. Kur është ballafaquar me raportin policor në lidhje me incidentin me flamur, ku është thënë se copa qelqi janë gjetur në tapet, ai ka thënë se ose nuk është pastruar krejtësisht një ditë përpara ose nuk është pastruar menjëherë, sepse nuk e kanë përdorur këtë aneks çdo ditë. Ai poashtu ka vërtetuar se është detyrë e muezinit të mbyllë të gjitha dyert e xhamisë.

Të dy dëshmitarët kanë vërtetuar se asgjë nuk është përdhosur apo dëmtuar brenda xhamisë. Në këtë mënyrë dëshmitë e tyre plotësisht kanë mbështetur deklaratën e të akuzuarit dhe Gjykata ka bazuar të gjeturat faktike në këto dëshmi.

Si hetues kryesor i këtyre dy incidenteve, **dëshmitari NN** ka vërtetuar të gjeturat në vendin e ngjarjes dhe ka vërtetuar raportet policore të përpiluara nga ai.

3. Provat lidhur me incidentin e të shtënave

I akuzuari deklaroi se pasi që zbriti nga xhamia dhe arriti tek udhëkryqi, humbi vetëdijen dhe nuk kuptoi gjë se çfarë ndodhi mëpastaj. Çasti vijues që i kujtohet është vizita e babait dhe avokatit të tij mbrojtës që i bënë atij sa ka qenë i shtrirë në spital.

Mirëpo, përcaktimi i rrjedhës së ngjarjeve që u zhvilluan atë natë në Stacionin e Policisë në jug të Mitrovicës sollën prova të mjaftueshme për Gjykatën.

Lëvizjet e të akuzuarit 10-15 minuta para të shtënave u xhiruan nga kamerat 1 dhe 2. Nga **Shiriti filmik** mjaft qartë shihet që i akuzuari kaloi Pikën Statike Një tre herë para se t'i drejtohej Zyrtari i Policisë FF rreth orës 01:22. Shihet, gjithashtu, që pas rreth një minuti, zyrtari i policisë e përcolli në drejtim të stacionit të policisë dhe që zyrtari i njëjtë është kthyer në vendin e tij të punës dhjetë minuta më vonë, pra rreth orës 01:34.

Saktësisht kështu, **dëshmitari** FF përshkruan ngjarjen: dëshmitari ka vërejtur që personi i panjohur ka ecur përreth dy apo tre herë, fillimisht në drejtim të urës drejt tregut dhe pastaj është kthyer. Madje, secilën herë që ky kalonte stacionin e policisë, merrte kohë që ta shihte. Nga kjo, dëshmitari kuptoi që diçka nuk ishte në rregull me këtë person dhe kur ky i fundit erdhi ballë për ballë me Pikën Statike Një dhe vendosi shallin apo peshqirin mbi kokë, dëshmitari doli nga postblloku i tij. Personi e vërejtë një gjë të tillë dhe filloi të lëvizte në drejtim të tij. Dëshmitari i kërkoi dokumentet e identifikimit, mirëpo i pari rrëfeu me gjeste që ishte shurdh-memec dhe filloi të tregonte në drejtime të ndryshme thuajse nuk kuptonte fare. Me të kuptuar dëshmitari që nuk do të mund të komunikonte, ky i gjestikuloi personit që ta ndiqte deri te pjesa e jashtme e rrethojës të stacionit të policisë. Thirri kolegun e tij, EE, i cili ishte në Pikën Statike 2, brenda rrethojës. EE erdhi dhe u përpoq të komunikonte me personin me anë të gjesteve, por kot. Thirrën Arjeta Xhoshën, e cila ishte përgjegjëse për ndërrimin. Ajo erdhi te rrethoja dhe qëndroi brenda. Edhe ajo u përpoq të komunikonte me këtë person, por nuk ia doli. Personi kishte pasur një çantë në krah dhe dëshmitari i tregoi çantën dhe i bëri me dije që ta hapte atë. Ai largoi çantën nga krahët, e hapi dhe e shkundi në mënyrë që të tregonte që ishte bosh. Pastaj, Arjeta Xhoshja u kthye në stacion për të thirrur një përkthyes. Ajo u kthye me Enver Pllanën dhe në atë çast, dëshmitari vendosi të kthehej në vendin e tij të punës pasi që kishte mjaft zyrtarë të policisë përreth.

Deklarata e FF gjitha shtu konfirmohet nga ajo e **dëshmitarit** EE, zyrtarit të policisë në Pikën Statike Dy (pika e vogël e informacionit brenda stacionit). Edhe ky përshkroi mënyrën e njëjtë se si personi shtirej si shurdh-memec, si u përpoq të komunikonte me të me anë të gjesteve, se si thirrën Arjeta Xhoshën, si kontrolluan çantën, dhe cili ishte brenda dhe jashtë murit rrethues. EE gjithashtu deklaroi se Arjeta Xhoshja këshilloi atë që të futej sërish brenda në stacionin e policisë, ku e priste një palë. Edhe Arjeta Xhoshja hyri brenda për të marrë Enver Pllanën për tu kthyer te personi jashtë.

Mënyra se si erdhi deri aty, sjelljet dhe veprimet e të akuzuarit para se të fillojnë të shtënat, siç u përshkruar nga dëshmitarët FF dhe EE konfirmohen edhe nga deklaratat e Rojës së Sigurimit të Ballkanit, dëshmitari CC. Edhe ai përshkroi se si i akuzuari kishte ecur lart e poshtë para kioskut të tij. Një gjë e tillë iu është dukur e dyshimtë dhe prandaj i tha policës femër që ta "shohë", por kontrolluan vetëm çantën e jo vetë personin dhe pastaj vendosën ta "lejnë se nuk qenka normal". Pasi që e kontrolluan, personi i është afruar kioskut të UNMIK-ut për praninë duke u shtirur si memec. Në mënyrë që të kuptonin se nga ishte, dëshmitari vizatoi një shtëpi dhe shkroi "Skenderaj" në të. Personi pohoi. Qëlloi një insekt i vogël brenda në kiosk dhe dëshmitari deshi ta largonte dhe mu në atë çast, personi i kapi dorën duke i bërë me dije që të mos e prekë insektin. Dëshmitari informoi zyrtaren femër që personi ishte nga Skenderaji dhe e udhëzoi që ta kontrollonte sërish. Zyrtarja femër thirri përforsime nga Skenderaji.

Roja tjetër e sigurimit e Ballkanit, dëshmitari DD dha po të njëjtin përshkrim lidhur me mënyrën se si erdhi deri aty, sjelljet e të akuzuarit, kontrollimin e çantës, zyrtarin duke thënë "lëreni se qenka i retarduar", si dhe incidentin me insektin dhe reagimin agresiv e të akuzuarit lidhur me këtë.

Pala e dëmtuar Arjeta Xhoshja, e cila ishte në ndërrim të mëngjesit më 14 qershor 2008 dhe që kishte filluar punën që në mesnatë, ishte përgjegjëse për zonën e sigurimit në Mitrovicë në gradën më të lartë. Ajo përshkroi sjelljet e të akuzuarit si dhe ngjarjen që u zhvillua para të shtënave në mënyrë të njëjtë sikurse edhe dëshmitarët FF, EE, CC dhe DD. Edhe ajo u përpoq të komunikonte me personin e panjohur, por kot. Pastaj u përpoq të kontaktonte një përkthyes për shurdh-memec, por nuk ia doli. Kur roja e sigurimit të UNMIK-ut i tregoi vizatimin me shtëpinë dhe fjalën "Skenderaj" të shkruar në të dhe e informoi që personi e kishte pranuar që ishte nga Skenderaj, ajo këtë e mori si të vërtetë dhe nëpërmjet radiolidhjes thirri një njësi në Skenderaj. Ajo poashtu konfirmoi që jashtë rrethojës, rreth gjysmë metri më larg, po qëndronte personi i panjohur dhe anën e tij të majtë ishte zyrtari FF, ndërsa në të djathtë ishte roja e sigurimit e UNMIK-ut. Ajo po qëndronte përballë tyre, brenda rrethojës me zyrtarin EE. Ajo poashtu konfirmoi se zyrtari FF u kthye në vendin e tij të punës dhe në ndërkohë Enver Pllana erdhi, por ajo nuk mund të kujtonte se si ai erdhi aty. Ajo e udhëzoi që të sillte personin brenda derisa të vinte njësia nga Skenderaj.

Lidhur me të shtënat jashtë dhe brenda stacionit të policisë, gjykata ka bazuar gjendjen faktike mbi një sërë deklaratash të dëshmitarëve, mbi raportin e vendngjarjes me foto-dokumentacion, mbi ekspertizën balistike si dhe mbi ekspertizën e ADN-së.

Pala e dëmtuar Enver Pllana në cilësinë e dëshmitarit deklaroi që doli për të marrë personin e panjohur me iniciativën e vet apo me urdhër të Rreshteres Xhoshja. Ai i vuri krahun në mënyrë shumë të butë pasi mendoi se personi ishte shurdh-memec. Ai i tha "eja me mua" dhe ecën krahpërkrah, ndërsa personin ishte në anën e tij të djathtë. Me t'u futur brenda, personi futi dorën e djathtë në xhepin e djathtë të xhaketës së tij me kapele, nxorri armën dhe shtiu në anën e djathtë të belit të Enver Pllanës dhe e qëlloi. Ky i fundit ndjeu dhembje. Personi filloi të largohej nga Enveri gjithnjë me fytyrë drejt tij dhe duke

mbajtur diçka në dorë. Dëshmitari priti që ky të qëllonte sërish, prandaj nxorri armën e tij zyrtare, Glock me numrin serik "KPS 3811" dhe filloi të shtinte në drejtim të tij. Më pas, i dyshuari u përkul duke u bërë kështu shënjestër më e vështirë, u largua 2-3 metra nga dera e hyrjes, ndaloi aty, u kthye dhe hyri nëpërmjet derës së rrethojës dhe filloi të shkante në drejtim të hyrjes së stacionit të policisë. Gjatë kësaj kohe, dëshmitari vazhdonte të shtinte në drejtim të personit të panjohur. Ai kishte dy karikatorë dhe ndërroi karikatorin që kishte fillimisht në armë duke supozuar që i pari ishte zbrazur. Gjatë intervistimit, ai konfirmoi se i akuzuari kishte shtënë në të vetëm një herë dhe që kishte dëgjuar një të shtënë. Ai theksoi që mund të fliste vetëm për atë që kishte ndodhur jashtë ndërtesës së stacionit, dhe se nuk kishte qasje në brendinë e saj. I kujtohet që Rreshterja Xhoshja ishte dikund afër, pranë rrethojës dhe që briti mjaft kur pa që është shtënë në të. Madje edhe roja e sigurimit ka mundur të ketë qenë afër, por ai nuk ishte i vëmendshëm për të kuptuar se kush që afër.

Pala e dëmtuar Arjeta Xhoshja në cilësinë e dëshmitares deklaroi që pasi që i kishte thënë Enver Pllanës të sjellte personin e panjohur brenda, ata i bënë me dorë që të vinte dhe personi filloi të ecte në drejtimin e tyre. Enver Pllana shkoi te hyrja, personi iu afrua dhe Enver Pllana lehtazi vendosi dorën e tij të djathtë rreth shpinës së personit. Ata filluan të ecnin në drejtim të stacionit dhe personi ishte në anën e djathtë të Enver Pllanës. Ajo ishte 2-3 metra larg tyre, para tyre. Pas një kohe, Enver Pllana dhe personi po qëndronin paralelisht me njëri-tjetrin, ishin shumë afër, pothuajse të ngjitur me njëri-tjetrin dhe personi veproi në mënyrë shumë të shpejt duke nxjerrë një armë nga pjesa e djathtë e rripit të tij me dorën e djathtë. I drejtoi armën Enver Pllanës dhe shtiu menjëherë duke shkaktuar kështu krismë të armës. Ai menjëherë krijoi distancë në mes të Enver Pllanës dhe filloi të shkante në drejtim të saj. Ajo ishte e tronditur. E dinte që nuk kishte të veshur jelek anti plumb, shtyu derën e hyrjes së stacionit dhe iku brenda. U përplas në prag dhe u rrëzoi me duar dhe këmbë në dysheme dhe nuk mund të ngritej dot. Disi ishte e bllokuar. U përpoq me të gjitha fuqitë që të ngritej, por nuk i punonin duart e as këmbët. EE e ndihmoi që të ngritej. Gjatë gjithë kësaj kohe, ajo dëgjoi të shtëna nga jashtë dhe mendoi se Enver Pllana kishte vdekur, pra që personi e kishte vrarë. Kur u ngrit në këmbë, nxorri armën dhe bëri dy apo tre hapa në korridor. Deshi të dilte për të ndihmuar Enver Pllanën, por personi hyri nga dera e jashtme dhe vinte drejt saj në mënyrë agresive. Ai ishte 2-2,5 metra larg saj. Ajo briti me gjithë zërin që kishte, por nuk e di se çfarë briti. Ajo gjithnjë po largohej nga ai ndërsa ai gjithnjë po vinte drejt saj. Filloi të shtinte, por ai vazhdonte të vinte në drejtim të saj. Kur arriti në korridorin e dytë, ajo vazhdoi të shtinte në drejtim të tij, por ai nuk rrëzohej dhe vazhdoi të vinte në drejtim të saj. Ajo shtiu 2 apo 3 herë dhe vërejti që atij po i dridheshin gjunjët. Më pas, ajo doli anash dhe pa personin duke u rrëzuar. Gjatë marrjes në pyetje, ajo shtoi që me t'u futur në stacion, personi po mbante diçka në dorë, por kjo nuk ia doli të shihte se çfarë. Ajo kishte me vete armën zyrtare Glock Model 19, numri serik KPS2283. Ajo nuk mund të thoshte sa herë kishte shtënë me armë, por e dinte që nuk kishte zbrazur karikatorin, i cili mbante 14 fishekë si dhe një gati për të shtënë.

Deklaratat e palëve të dëmtuara mbështeten nga deklaratat e dëshmitarit FF në pjesën përkatëse:

Pasi që dëshmitari u kthye brenda në kabinë në Pikën Statike Një, është ulur dhe pastaj dëgjoi një të shtënë arme. Ai nuk mund të shohë se cili kishte shtënë. Menjëherë pas kësaj, dëgjoi të shtëna të tjera. Por, ajo e para veçohet nga të tjerat, me një pushim të shkurtër para të shtënave të tjera. Me të dëgjuar të shtëna të tjera, ky nxorri armën nga brezi, vrapoi jashtë dhe u mbështet në njërin nga veturat e policisë para stacionit. Me ndaljen e të shtënave, ai u drejtua për të parë se nga vinin ato dhe pa personin e panjohur duke u futur në stacion të policisë. Personi ishte disi i përkulur dhe nuk përdori dorën për të hapur derën e stacionit të policisë, por e shtyu derën me supin e tij të majtë. Pasi që u fut personi brenda, dëshmitari dëgjoi zërin e Arjeta Xhoshës, kjo e fundit briti mjaft dhe pastaj ai dëgjoi edhe të shtëna të tjera. Deshi të futej brenda në stacion, mirëpo nuk u fut ngase pa Enver Pllanën, i cili i tha që ky person e kishte qëlluar me armë. Pas kësaj, ai mori Enver Pllanën për krahu dhe e vendosi në veturën e njësisë nga Skenderaji, e cila kishte ardhur për të ndihmuar dhe u nis për në qendrën mjekësore.

Dëshmitari dha një përshkrim shumë të saktë të ngjarjes. Në orën 01:36:43, kamera 1 xhiro lëvizjet reaguese të zyrtarit të policisë duke dalur nga kabina me armë në dorë, duke u pozicionuar pas një veture dhe duke u nisur më pas drejt stacionit të policisë. Zhvillimi i fundit i ngjarjes gjithashtu është xhiruar nga kamera 1, një veturë të policisë duke ardhur para stacionit në 01:37 dhe disa policë duke u kthyer në veturë dhe nisur në drejtim të Qendrës Mjekësore në orën 01:38.

Gjithashtu edhe deklaratat e dëshmitarit EE është në përputhje me deklaratën e Arjeta Xhoshës. Dëshmitari EE deklaroi që pasi që Rreshterja Xhoshë dhe Enver Pllana dolën nga stacioni i policisë lidhur me personin e panjihur, të shtëna janë dëgjuar, fillimisht një-dy, pastaj një pushim dhe pas pushimit u dëgjua një zhurmë sikur ajo e fishekzjarreve. Ai la palën me të cilën kishte qenë dhe u nis drejt hyrjes, por nuk doli pasi që Arjeta Xhoshë hapi derën nga jashtë dhe ra para tij. Ai e mori për krahu dhe e ngriti derisa dëgjoi të shtëna. Arjeta Xhoshë i tha: “kujdes, ka armë, ka shtënë në Enver Pllanën.” Ajo e shtyu atë dhe lëvizi 2-3 hapa brenda stacionit dhe ai iu afrua palës që ishte në një dhomë të vogël, mbuluar me xham brenda korridorit. Personi erdhi shpejt dhe hyri nga dera në pozicion mbrojtjeje me supet e tij. Në çastin kur preku derën, diçka ra përtokë. Arjeta Xhoshë e urdhëroi që të ndalonte dhe filloi të shtinte me armë. Në atë çast, EE urdhëroi palën që të shtrihej në dysheme. Ai e kishte parë që i dyshuari po lëvizte vetëm në drejtim të Arjeta Xhoshës dhe po përpiquej që në mënyrë shumë brutale të vinte tek ajo. Mirëpo, që në kthesën e parë të korridorit, i dyshuari filloi të ngadalësohej dhe të çalojë. Tani, ai i tha Arjeta Xhoshës të mos shtinte më dhe i dyshuari ra përtokë.

Zyrtarët e tjerë të policisë brenda stacionit në kohën e të shtënave, dëshmitari GG, i cili ishte në dhomën e intervistimeve, dëshmitari HH, i cili kishte qenë në të ashtuquajturën “dhomë të rreshterit”, dëshmitari JJ, i cili ishte pranë qelive duke marrë shënime, dëshmitari OO, i cili ishte radio-tekniku në bazë të stacionit, dhe dëshmitari TU në zyrën e stacionit, nuk mund të shtonin detaje të tjera lëndës, mirëpo konfirmonin detaje të vogla të deklaratave të dëshmitarëve të mëparshëm lidhur me të shtënat e dëgjura, me mënyrën se si i akuzuari është futur në

stacion, rendi i të shtënave nga Arjeta Xhosha brenda stacionit, pasojat e ngjarjes, gjendjen dhe vendin e të lënduarit, etj. Po e njëjta gjë i referohet edhe deklaratës së dëshmitarit XU, një civil që po merrej në pyetje në stacion të policisë nga Leonora Terbunja dhe që ishte në të njëjtën zyre me të në çastet e të shtënave, dëshmitari TU, i cili jeton në shtëpinë fqinje në anën tjetër të rrugës dhe dëshmitari KK

Sigurisht që kishte papërputhshmëri të vogla në deklaratat e dëshmitarëve për shkak të zhvillimit të papritur dhe të shpejtë të ngjarjeve (në 01:36:43 të shtënat e para jashtë-reagimi i zyrtarit FF i xhiruar me kamerën 1, një minutë e shtatë sekonda më vonë, në 01:37:50 vetura e njësisë nga Skenderaji nisët për në Qendrën Mjekësore duke bartur të lënduarin Enver Pllana dhe në 01:42:05, vetura e ndihmës së parë arrin në stacion). Për më tepër, ishte kjo një ngjarje e pazakontë dhe e papritur. Varësisht nga karakteret e ndryshme, gjendjet e ndryshme fizike dhe psikologjike të dëshmitarëve, është shumë e natyrshme që edhe kur përjetojnë të njëjtën gjë, detajet u kujtohen në mënyrë të ndryshme. Shembull që shërben për të ilustruar një gjë të tillë është deklarata e CC lidhur me të shtënën e parë. Ai përgjigjet në pyetje duke thënë që i akuzuari fillimisht shtiu në rreshteren, por nuk e qëlloi atë por derën. Rreshterja vrapoi brenda dhe pastaj i akuzuari shtiu në Enver Pllanën. Edhe ai vetë e pranoi që kishte qenë mjaft i traumatizuar nga këto ngjarje, por sidoqoftë, provat forenzike, raporti i vendit të ngjarjes i cili rrëfen vendin e saktë ku janë gjetur fishekët e zbrazur si dhe raporti ballistik që identifikoi se nga cila armë u zbrazën ato, mbështesin deklaratën e dëshmitarëve të tjerë. Prandaj, Gjykata e vlerëson këtë pjesë të deklaratës së besueshme të dëshmitarit si gabim i thjeshtë në kujtimin e asaj që kishte ngjarë si pasojë e traumës së shkaktuar.

Raporti Forenzik i vendit të ngjarjes i përpiluar në mënyrë shumë të detajuar dhe të saktë dhe i vërtetuar gjatë shqyrtimit kryesor nga dëshmitari TT, me listën e bashkangjitur të provave, foto albumin dhe listën e matjeve, së bashku me ekspertizën balistike të përgatitur dhe të vërtetuar gjatë shqyrtimit kryesor nga dëshmitari ekspert WW, i mundësuan gjykatës të përcaktojnë sa herë është shtënë, ku dhe nga cila armë, si dhe lëvizjet e të lënduarit Djordjevic Predrag.

Janë gjetur gjithsej nëntëmbëdhjetë fishekë të kalibrit 9 dhe një fishek i kalibrit 7.65. Këto janë zbrazur nga tre armë të ndryshme.

Nëntë fishekë të kalibrit 9 janë gjetur jashtë, tetë prej tyre janë gjetur në oborr, në anën e majtë dhe një është gjetur përpara hyrjes së oborrit të stacionit të policisë. Këto janë shtënë nga arma "Glok" modeli 19, kalibri 9x19 me numrin serik "KPS 3811". Kjo armë është arma zyrtare e policit Enver Pllana.

Dhjetë fishekë të kalibrit 9 janë gjetur brenda ndërtesës së stacionit të policisë. Pesë sosh janë gjetur përpara hyrjes dhe pesë të tjera në fund të koridorrit. Këto janë zbrazur nga arma "Glok" modeli 19, kalibri 9x19 me numrin serik "KPS 2283". Kjo armë është arma zyrtare e Rreshteres Arjeta Xhosha.

Fisheku i kalibrit 7.65 është gjetur në oborrin e stacionit të policisë, në këndin e majtë të ndërtesës. Siç e përshkruan me saktësi raporti i ballistikës, kjo është pjesë e gëzhjës së plumbit të kalibrit 7.65x17 mm dhe është zbrazur nga arma "Jieffeco" modeli 1907, kalibri 7.65x17 mm me numrin serik "20643". Këtë armë e kishte Djordjevic Predrag me vete atë natë dhe sipas deklaratës së tij, ai gjithnjë e mbante këtë me vete kur ka qenë çoban, për vetëmbrojtje dhe për të frikësuar ujqët. Kjo armë është gjetur në anën e majtë të hyrjes së stacionit të policisë atëherë kabinës së sigurimit Ballkan (Postblloku i UNMIK-ut) me një plumb të dëmtuar në folenë (tytën) e armës.

Raporti forenzik i vendit të ngjarjes gjithashtu konfirmon lëvizjet e të lënduarit të akuzuar me anë të fotografimit të gjurmëve të gjakut dhe matjes së distancës së mes tyre. Një pellg i vogël gjaku është gjetur pranë armës Jieffeco, pika të shpërndara gjaku në asfaltin para kioskut, pastaj spërkatje gjaku drejt hyrjes së stacionit të policisë, gjurma gjaku në derën e hyrjes së stacionit të policisë, në përqëndrim më të madh në lartësi të drynit të derës, gjurmë gjaku në drynin e derës, gjurmë gjaku në dysheme afër tavolinës në gjendet në korridor, në tavolinën afër derës së hyrjes, gjurmë gjaku në pjesën e parë të korridorit duke vazhduar drejt pjesës së fundit të korridorit si dhe një pellg gjaku në vendin ku kishte qenë i shtrirë i akuzuari pas rrëzimit. Mostra të këtyre gjurmëve të gjakut janë marrë dhe **ekspertiza e parë e ADN-së** konfirmoi se ato përputhen me profilin e ADN-së së Djordjevic Predrag.

Raporti i vendit të ngjarjes gjithashtu konfirmon deklaratën e Arjeta Xhoshës, e cila thotë që i akuzuari po mbante diçka në dorë si dhe deklaratën e EE, i cili thotë që diçka ka rënë në dysheme kur personi ka goditur derën. Një thikë palosëse me tehtë mbyllur është gjetur përpara derës së stacionit të policisë.

4. Provat lidhur me pikën e akuzës për vepra terroriste

Lidhur me pikën e akuzës për vepra terroriste, janë dëgjuar disa dëshmitarë me qëllim që të kuptohet se a kishte i akuzuari në mesin e gjësëndeve të tij edhe kartelën e anëtarësimit në Grupin Car Lazar dhe për të njoftuar gjykatën mbi aktivitetet e Grupit Car Lazar si dhe atyre të Beretave të Kuqe.

Me të tërhequr Prokurori Publik pikën e akuzës për vepra terroriste para përfundimit të shqyrtimit kryesor, gjykata shpërfillë vlerësimin e deklaratave të **dëshmitarëve**

PP, QQ, SS, UU, VV, ZZ, XX.

5. Provat lidhur me gjendjen mendore të të akuzuarit, konsumimin e tij të alkoolit si dhe ndjenjat e tij të thella fetare

Vlerësimi psikiatrik i Djordjevic Predrag sjellë në pah një pamje të qartë të gjendjes mendore të të akuzuarit. Asnjë prej palëve nuk kundërshtoi këtë ekspertizë dhe u kërkua kontrollimi i drejtpërdrejtë i të akuzuarit dhe asnjë prej palëve nuk bëri kërkesë për ekspertizë të re. Në ekspertizën e saj përfundimtare, MZ _____ përfshiu edhe Raportin Psikologjik, të datës 05/11/2009, kryer nga _____, specialiste në psikologji klinike, Divizioni i Psikiatrisë, QKUK.

Eksperti ka ardhur në përfundim duke thënë që në kohën e kryerjes së veprës, **aftësia mendore** e të akuzuarit për të mbajtur veten nën kontroll dhe për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij, ishte e **kufizuar, por jo në nivel shumë të lartë. Aftësia e tij për të menduar në mënyrë të shëndoshë dhe për të marrë vendime** ishte e **kufizuar**.

Mendimi i ekspertit është shumë i qartë dhe nuk përmban kundërshtime. Prandaj, Trupi Gjykes e pranoi atë në tërësi dhe u mbështet në konkludimet e tij (shihni edhe pikën F).

Trupi Gjykus kishte mundësinë që të vrojtojë ca nga shenjat e personalitetit psikotik të Djordjevic Predrag gjatë shqyrtimit kryesor, shpërthimet e tij të të qeshurave pa vend dhe pa ndërlidhje në njërin anë dhe apatinë e plotë ndaj asaj që zhvillohej përreth tij dhe lidhur me të në anën tjetër.

Edhe sqarimet e tij lidhur me ato që i paraprinë veprës penale përmbajnë disa shenja të personalitetit psikotik:

Sjellja e tij, siç edhe reflektohet nga vetë ai, është e përshkruar në ekspertizën psikiatrike si në vijim:

Personaliteti asocial i Djordjevic Predrag si dhe **nevoja impulsive për të dëshmuar veten** motivuan veprimin e tij. Ai konsumonte alkool edhe si nevojë impulsive edhe për të mbledhur guximin për të dëshmuar veten. Ai është i vetëdijshëm për efektet negative të nxitjes së tij për të konsumuar alkoolin si dhe për paaftësinë për t'u përmbajtur paskëtaj.

Lidhur me prirjen e tij të konsumimit të alkoolit, ai i tha Trupit Gjykues që gjatë dimrit që parapriu incidentin, ai kishte konsumuar mjaft alkool kur nuk kishte punë. Ndaloi së konsumuari alkool pas katër muajve. Ai filloi të pinte sërish pas presionit të padurueshëm në kokën e tij por edhe për t'u qetësuar.

Fatkeqësisht, pas sjelljes së të akuzuari në QKUK, nuk është testuar gjaku i tij për gjurmë alkooli. Sasia e alkoolit që ka konsumuar ky para kryerjes së veprave penale mund të vlerësohet vetëm nga deklaratat e tij dhe nga deklaratat e dëshmitarëve që konfirmuan pohimet e Djordjevic Predragut.

Dëshmitari MM, pronar i kafenesë Bip-Bap bar konfirmoi praninë e Djordjevic Predragut në kafene. **Dëshmitari** LL, kamariet, i kujtohet që personi ka porositur një shishe të vogël të verës Vranac dhe pastaj edhe dy të tjera.

Dëshmitari CC gjithashtu deklaroi që i akuzuari piu mjaft cigare, piu tre apo katër shishe të vogla vere dhe një apo dy pije të tjera. Ai dukej mjaft i humbur.

Dëshmitari ZO gjithashtu vërejti që i akuzuari ishte ose i dehur ose nën ndikim të narkotikëve pasi që i kishte sytë e çuditshëm. **Dëshmitari** EE përshkroi sjelljet e të akuzuarit si shumë të qeta, "i përgatitur mirë", mirëpo buzët shumë të thata.

Dëshmitari FF përshkroi personin si shumë të zbehur dhe të lodhur, djersitej dhe sikur kishte frikë.

Devotshmëria e madhe e Djordjevic Predragut ndaj fesë së tij ortodokse dhe të krishterë reflektohet në deklaratat e tij dhënë në Gjykatë si dhe në deklaratat e dhëna ekspertit psikiatrik.

Në mesin e gjësendeve të të akuzuarit, kishte fotografi fetare, broshura të vogla fetare dhe gjësende të tjera fetare. Ai deklaroi që gjithnjë i mbante këto gjëra me vete. Gjykata ka vlerësuar që i akuzuari me të vërtetë është njeri shumë fetar.

6. Kërkesat e refuzuara

Gjatë shqyrtimit kryesor më 1 shtator 2009, trupi Gjykues refuzoi propozimin për të ftuar dy dëshmitar nga Prokurori Publik në seancën e konfirmimit dhe të konfirmuar gjatë seancës së 27 korrikut 2009.

Ftesa zyrtare e ekspertit të ADN-së **PQ** është refuzuar për shkak se deri atëherë, asnjë palë nuk ka pasur ndonjë kundërshtim dhe as nuk ka kërkuar qartësime lidhur me ekspertizën e saj të ADN-së dhe udhëtimi i saj nga Kroacia do të kishte marrë kohë dhe do të nevojiteshin mjaft të holla. (Më vonë, Prokurori Publik është shprehur i kënaqur me kërkesën për qartësime me shkrim nga eksperti, mirëpo duke pasur parasysh rezultatit e analizës së dytë të ADN-së, nuk ka pasur nevojë që të priten qartësimet në fjalë.)

Marrja në pyetje e zyrtarit të policisë **NH** është refuzuar pasi që roli i tij i vetëm në këtë rast ishte përcjellja e të pandehurit nga spitali në qendrën e paraburgimit. Raporti që dorëzoi ky i fundit nuk përmbante asnjë informacion tjetër përpos asaj që i pandehuri kishte thënë gjatë rrugës. Ky raport është shpallur provë e papranueshme me një vendim të veçant të Trupit gjykues të sjellur më 10 gusht 2009. Pasi që Prokurori Publik nuk ka provuar se ky zyrtar i policisë mund të ketë informacione të tjera lidhur me rastin, kërkesa është refuzuar.

E. KUALIFIKIMI LIGJOR

Veprat penale janë kryer më 14 qershor 2008. Atëbotë, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), i cili hyri në fuqi më 06 prill 2004, ishte ligji i aplikueshëm. Në pajtim me nenin 2, paragrafi (1) i KPPK, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të zbatohet ndaj kryerësit. Nuk është bërë asnjë ndryshim në ligj që të ishte në favor të të akuzuarit. Edhe pse ai është akuzuar sipas Kodit Penal të Kosovës, i cili hyri në fuqi më 06 janar 2009, nenet relevante janë identike në që të dy kodet. Prandaj, gjykata iu referua dispozitave të KPPK-së si ligjit të aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprave penale.

A) Me anë të vendosjes së flamurit, i cili simbolizon fenë ortodokse dhe të krishterë, në kupolën e xhamisë, i akuzuari ka kryer veprën penale të Nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose të mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik në kundërshtim me Nenin 115, paragrafi (1) të KPPK. Në ambientin e ndieshëm aktual shoqëroro-politik në Kosovë, është e pakundërshtueshme që vënia e simbolit të fesë ortodokse dhe të krishterë mbi një xhami me shumë gjasë do të trazonte rendin publik dhe mund të nxisë dhe përhapë mosdurim fetar dhe etnik në mënyrë publike. Ligji nuk kërkon që trazimi i rendit publik realisht të ndodhë si pasojë e veprimit.

Prokurori Publik ka ngarkuar të akuzuarin me kualifikimin e veprës penale duke iu referuar paragrafit (3) për shkak të dritares së thyer në xhami. Mirëpo, AA dhe BB konfirmuan deklaratën e të akuzuarit, sipas së cilit asgjë nuk është përdhosur apo dëmtuar në xhami dhe se dritarja ishte thyer një ditë më parë. Prandaj, Trupi Gjykses e shpallë të akuzuarin fajtor për kryerjen e veprës penale sipas nenit 115, paragrafi (1) të KPPK dhe nuk i referohet paragrafit (3).

B) Lidhur me incidentin në stacionin e policisë, i akuzuari ka kryer veprën penale të Vrasjes së rëndë në tentativë në kundërshtim me nenin 147, pika 10 të KPPK lidhur me nenin 20 të KPPK. Prokurori Publik e ngarkoi me veprën e njëjtë penale, mirëpo iu referua edhe pikave 5 dhe 11.

Gjykata e vlerësoi si të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se qëllimi i të akuzuarit ishte të vrasë zyrtarin e policisë Enver Pllana dhe refuzoi versionin e mbrojtjes, sipas së cilit, qëllimi i vetëm i klientit ishte të shkaktojë lëndim të rëndë trupor. Përdorimi i armës dhe të shtënat nga një distancë kaq e vogël në pjesën e trupit ku gjenden organet vitale tregon në mënyrë të qartë dëshirën e të akuzuarit për të vvarë. Ai ishte i vendosur për të vvarë. Ai kreu veprën penale me qëllim të drejtpërdrejtë, me vetëdijë të plotë mbi situatën dhe pasojat e veprimit. Ishte vetëm fat që rezultati doli të jetë lëndim i rëndë trupor dhe jo vdekje. Është e pamohueshme që Enver Pllana ishte duke kryer detyrën e tij për mbrojtje të rendit ligjor, prandaj iu referohet pikës 10.

Mirëpo, qëllimi i Djordjevic Predragut mund të vërtetohet vetëm sa u përket veprimeve të tij ndaj Enver Pllanës. Ai kishte dy fishekë në armë, ai shtiu një herë në Enver Pllanën. Edhe pse fisheku i dytë që mbeti në fole ishte i dëmtuar, eksperti i balistikës dha një përgjigje të qartë duke thënë që nuk është e mundur që ai të jetë dëmtuar gjatë përpjekjes për të shtënë. Nuk ka provë që vërteton se i akuzuari kishte për qëllim të shtinte për herë të dytë. Me t' u lënduar, ai lëshoi armën e tij dhe shkoi në hyrje të stacionit të policisë me thikë në dorë. Mirëpo, më të hyrë në stacion të policisë duke e përplasur atë, ai lëshoi thikën. Mirëpo, ai akoma shkonte në drejtim të Arjeta Xhoshës. Nuk ka provë që vërteton se pasi ky u përpoq të vrasë Enver Pllanën, kishte qëllim që të vrasë Arjeta Xhoshën apo ndonjë zyrtar tjetër të policisë. Ai nuk shtiu për herë të dytë dhe as që hapi thikën palosëse kur e kishte në dorë (kjo është gjetur e mbyllur para hyrjes së stacionit). Ai kishte me vete edhe një thikë tjetër, por asnjëherë nuk e nxorri atë. Ai vazhdonte të lëvizte përpara në drejtim të Arjeta Xhoshës, por nuk kishte asgjë në dorë dhe tashmë ishte i lënduar.

Pasi nuk është e mundur të përcaktohet qëllimi i të akuzuarit ndaj Arjeta Xhoshës apo zyrtarëve të tjerë të policisë, Gjykata nuk i referohet pikës 11 të nenit 147, i cili i referohet dy apo më shumë vrasjeve të kryera qëllimisht.

Mirëpo, Gjykata ende e vlerëson Arjeta Xhoshën si palë të dëmtuar. Ajo është palë e dëmtuar në lidhje me veprën penale të kryer kundër Enver Pllanës. Me të parë kolegun në të cilin është shtënë, ajo vrapoi brenda, u rrëzua dhe lëndoi veten duke prere në këtë mënyrë tendinet në pjesën e epërme dhe të poshtme të krahut.

Gjykata nuk i referohet as pikës 5 të nenit 147. Pika 5 i referohet rastit kur njëri privon tjetrin nga jeta duke vepruar në mënyrë të pamëshirshme dhe të dhunshme. Vepra e vrasjes është gjithnjë e dhunshme. Në mënyrë që të konsiderohet ajo si formë e rëndë e vrasjes, niveli i brutalitetit duhet të tejkalojë nivelin e zakonshëm të dhunës në aktin e privimit të tjetrit nga jeta. Objektivisht, të shkaktojë dhimbje të mëdha dhe të gjata dhe vuajtje ekstreme. Subjektivisht, kryerësi demonstroi pandjeshmëri ekstreme ndaj vuajtjes së viktimës. Asnjëra prej këtyre nuk zbatohet në rastin konkret.

I akuzuari është penalisht përgjegjës për veprimet e tij. Ekspertiza psikiatrike në mënyrë të qartë u përgjigj duke thënë që ai nuk mund të konsiderohet si mendërisht i paaftë e as që të ketë aftësi të zovëgluar mendore siç kërkohet nga neni 12 i KPPK ngase aftësia për të mbajtur veten nën kontroll dhe për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij ishte e kufizuar, por jo në nivel të lartë. Neni 12, paragrafi (2) kërkon aftësi "dukshëm të zvogëluara".

C) Në pajtim me nenin 389, pika 1 e KPPPK, Trupi Gjykoes ka refuzuar pikën e akuzës për Kryerjen e veprave terroriste në kundërshtim me nenin 110, paragrafët (1) dhe (2) të KPPK lidhur me nenin 109, paragrafi (1), pikët 2, 7, dhe 10 të KPPK ngase Prokurori Publik është tërhequr nga kjo pikë e akuzës para përfundimit të shqyrtimit kryesor gjatë seancës së 17 nëntorit 2009.

Në aktgjykim dhe përgjatë gjithë shqyrtimit kryesor, Gjykata i është referuar dispozitave relevante të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës për shkak të rrethanave të veçanta në veri të Mitrovicës. Dispozitat e aplikuara të KPPPK-së janë plotësisht identike me ato të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

F. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

Kur përcaktohet sanksionit penal, Gjykata duhet të ketë parasysh qëllimin e përgjithshëm të dënimit, pra frenimin e aktiviteteve të dëmshme për shoqërinë duke dekurajuar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale si dhe qëllimin specifik, pra parandalimin e kryerësit nga përsëritja e veprave. Gjatë përcaktimit të kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata duhet të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues në pajtim me nenin 64, paragrafi (1) të KPPK.

Gjykata vlerësoi si faktor rëndues që i akuzuari kreu veprën penale me keqdashje, duke u shtirur si invalid duke fituar kështu besimin dhe simpatinë e zyrtarëve të policisë. Rrethanë tjetër rënduese është fakti që shkaktoi lëndim të rëndë trupor me pasojat të mundshme afat-gjate ngase plumbi akoma gjendet në trupin e palës së dëmtuar.

Mirëpo, rrethanat lehtësuese peshojnë më shumë se sa ato rënduese. I akuzuari nuk ka dosje penale dhe mbetet fakt që njëra prej veprave të tij penale është tentativë, edhe pse jo si pasojë e veprimeve të tij. Rrethanë veçanërisht lehtësuese është gjendja e tij e çekuilibruar mendore, personaliteti i tij psikotik, dhe aftësia e tij e kufizuar për të marrë

vendime, siç është përshkruar në vlerësimin psikiatrik. Gjykata është e mendimit që kjo rrethanë është po aq lehtësuese sa kërkohet në nenin 66, pika 2 e KPPK, gjë e cila lejon Trupin gjykues të sjellë një dënim më të lehtë se minimumi i paraparë me ligj në nenin 67 të KPPK.

Për veprën penal të Nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik në kundërshtim me nenin 115, paragrafi (1) të KPPK, ligji parasheh dënim me gjobë apo burgim deri në 5 vjet. Duke marrë parasysh të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, Trupi Gjykues caktoi 6 muaj burgim për këtë veprë penale.

Për veprën penale të Vrasjes së rëndë në tentativë në kundërshtim me nenin 147 të KPPK, ligji parasheh dënim me burgim prej së paku 10 vjet ose burgim afat-gjatë. Me zbatimin e nenit 66, pika 2 dhe neni 67, paragrafi (1), pika 2 e KPPK, Trupi Gjykues caktoi dënimin me 6 vjet burgim.

I akuzuari ka kryer dy vepra penale. Në pajtim me rregullat për llogaritjen e dënimit për bashkim të veprave penale, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se secili dënim veç e veç, por jo në lartësi të dënimeve të caktuara. Trupi Gjykues ka caktuar dënimin unik prej 6 vjet dhe 3 muaj burgim në pajtim me nenin 71, paragrafët (1) dhe (2) pika 2) të KPPK.

I akuzuari ka qenë në paraburgim që nga 14 qershori 2008. Kjo periudhë përfshihet në dënimin e caktuar të burgimit në pajtim me nenin 73, paragrafi (1) të KPPK.

G. SHPENZIMET

I akuzuari është shpallur fajtor. Prandaj, ai duhet të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102, paragrafi (1) të KPPK, përveç shpenzimeve të përkthimit gjatë tërë procedurës penale. Një aktvendim i veçantë mbi shpenzimet do të lëshohet pas pranimit të informacioneve në fjalë në pajtim me nenin 100, paragrafi (2) të KPPK.

H. KËRKESA PËR KOMPENSIM

Në fillim të shqyrtimit kryesor, palët e dëmtuara janë udhëzuar që kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për kompensim gjatë procedurës penale në pajtim me nenin 355, paragrafi (2) të KPPK.

Pala e dëmtuar Enver Pllana ushtroi kërkesë për kompensim më 12/10/2009 për shumën prej €4.150 për dëm material dhe €29.000 për dëm ndaj personit fizik, gjithsej €33.150.

Ai dorëzoi ca dokumente lidhur me operacionin për mënjanim të predhës - faturën prej rreth € 3.000 dhe faturën e vizitave mjekëve specialistë prej €60. Ai bashkangjiti edhe dokumentacionin mjekësor. Pala e dëmtuar Arjeta Xhoshja ushtroi kërkesë për kompensim më datën 12/10/2009 në shumën prej €950 për dëme materiale dhe €8.000 për dëme jomateriale, gjithsej €8.950. Në kërkesën e saj ajo deklaroi që Policia e Kosovës pagoi trajtimin e saj mjekësor, por që kishte pasur shpenzime shtesë. Ajo nuk dorëzoi dokumente të tjera shtesë.

Çështja e vërtetimit të arsyeshmërisë së këtyre kërkesave dhe nivelit të tyre do të kishte kërkuar akoma më shumë hulumtime dhe prova, gjë e cila do të kishte zgjatur dukshëm procedurën penale. Prandaj, Gjykata udhëzon palët për të ngritur padi të veçantë civile në pajtim me nenin 112, paragrafi (2) të KPKPK.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë
P. nr. 134/08

Përpiluar në gjuhën angleze si gjuhë e autorizuar.

Bashkëpunëtore Profesionale

Kryetar i Trupit Gjykues

Tara Khan

Hajnalka Veronika Karpati

Mjeti ligjor:

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim ndaj këtij vendimi nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës pesëmbëdhjetë ditë nga data e pranimin të këtij aktgjykimi.